

Vendim nr. 134 datë 21.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 21.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (L) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **LULZIM ALLA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i shkresës nr. 7761/1 prot., datë 16.12.2022 të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe i urdhrit nr. 15, datë 07.02.2023 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 17, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 31, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relaoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), ndaj shtetases A.P., gjyqtare në Gjykatën e

Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Korrupsioni aktiv/pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parashikuara nga nenet 248, 319 dhe 319/ç të Kodit Penal (KP).

2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, me shkresën nr. 776/1 prot., datë 16.12.2022, ka vlerësuar se nga shqyrtimi i kallëzimit penal të paraqitur nga kërkuesi nuk ofrohet asnjë e dhënë, indicie ose provë që të legjitimojë regjistrimin e procedimit penal për ndonjë vepër penale korruptive dhe ky organ nuk ka kompetencë në lidhje me këtë kallëzim penal, për shkak të thelbit të pretendimeve të ngritura dhe mungesës së të dhënave për vepra penale që bëjnë pjesë në sferën e kompetencës së kësaj prokurorie. Në këto kushte, kallëzimi penal i kërkuesit i është përcjellë për kompetencë lëndore dhe territoriale Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

3. Pas kërkesës së kërkuesit për deklarimin absolutisht të pavlefshëm të njoftimit nr. 776/1 prot., datë 16.12.2022 të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO e Shkallës së Parë), me vendimin nr. 579, datë 23.12.2022, ka vendosur rrëzimin e saj si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

4. Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO e Apelit), me urdhrin nr. 15, datë 07.02.2023, ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkuesit dhe miratimin e mosfillimit të procedimit penal të bërë nga ai për gjyqtaren A.P.

5. Në datën 09.05.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e shkresës nr. 776/1, datë 16.12.2022 të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe urdhrit nr. 15, datë 07.02.2023 të GJKKO-së së Apelit.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar:

6.1. *E drejta e ankimit*, pasi GJKKO-ja e Apelit ka disponuar me urdhër dhe jo me vendim, në kundërshtim me nenet 428 dhe 430/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Në këtë mënyrë kërkuesi nuk ka mundur të ushtrojë të drejtën e paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë.

6.2. *Parimi i një gjykimi të drejtë, parimi i paanshmërisë dhe i gjykimit nga një gjykatë e pavarur*, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, pasi GJKKO-ja e Apelit ka dalë jashtë objektit të kërkesës së bërë nga kërkuesi, nuk ka zhvilluar një gjykim në përputhje me KPP-në, duke disponuar me urdhër, ndërkohë që duhet të dispononte me vendim.

6.3. *Neni 17 i Kushtetutës*, pasi në këtë rast, kufizimi që i është bërë së drejtës së ankimit është joproporcional, jo në interes publik dhe ka cenuar thelbin e lirisë dhe të drejtën për t'u ankuar në një gjykatë më të lartë.

6.4. *Neni 148 i Kushtetutës*, pasi me nxjerrjen e shkresës nr. 776/1 prot., datë 16.12.2022 të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për shpalljen e moskompetencës është cenuar pavarësia e brendshme e prokurorëve. Kjo ndërhyrje përbën shkelje kushtetuese, për shkak se ka bërë të mundur moszbatimin e neneve 9/a, 24, 25, 58 dhe 84 të KPP-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në drejtim të përmbushjes së këtyre kriterëve, kërkuar, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individ duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtijshëm ose në tejzgjatjen e

cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 3 datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka mbajtur qëndrimin se, përjashtimisht, kontrollit të saj i nënshtrohen edhe ato vendime të ndërmjetme, karakteri i të cilave do të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Megjithatë, ky përjashtim zbatohet vetëm nëse plotësohen njëherazi tre kushte: (i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) dhe vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nga shqyrtimi i akteve bashkëlidhur këtij ankimi kushtetues individual, rezulton se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe urdhrin e GJKKO-së së Apelit të dhëna për ankimin e tij ndaj shkresës përcjellëse të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, që kanë vendosur dërgimin e kallëzimit penal të paraqitur nga ai në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Sipas tij, kjo shkresë e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme ka cenuar pavarësinë e prokurorëve, ndërsa urdhri i GJKKO-së së Apelit, në thelb, i ka cenuar të drejtën e ankimit. Bazuar në këto akte Kolegji vëren se nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur rekurs ndaj tyre, të cilat janë bërë dhe objekt i ankimit kushtetues individual, dhe as nuk rezulton të ketë sjellë ndonjë argument për këtë fakt.

12. Kolegji çmon se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, vlerësimi i prokurorit për përcaktimin e kompetencës, si edhe vendimi gjyqësor dhe urdhri, që kanë shqyrtuar ankimin e kërkuesit ndaj këtij disponimi, kanë natyrë të ndërmjetme në procedimin penal që po zhvillohet, pasi nuk zgjidhin në themel çështjen e tij. E thënë ndryshe, procedimi penal i vënë në lëvizje nga kërkuesi në lidhje me kallëzimin penal ndaj gjyqtarës A.P. është ende në vijim, në fazën e hetimeve paraprake.

13. Aktet e kundërshtuara nga kërkuesi nuk konsiderohen përfundimtare për qëllim të kontrollit kushtetues dhe ai i ka të gjitha mundësitë që pretendimet me natyrë kushtetuese t'i

paraqesë si gjatë procedimit penal në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm deri në Gjykatën e Lartë, ashtu edhe në kundërshtimin eventual të vendimit përfundimtar në këtë Gjykatë.

14. Për sa më sipër, kërkuksi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për të kundërshtuar aktin e prokurorit për përcaktimin e kompetencës dhe urdhrin e GJKKO-së së Apelit, që është dhënë për ankimin e tij ndaj këtij akti, pasi, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ai ka ende mjete juridike efektive në dispozicion për shërimin e të drejtave të pretenduara si të cenuara. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes të kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.